



Prishtinë: 12.10.2012

Kodi i ZRRE-së: V\_475\_2012

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_813\_06\_12

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreut IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_813\_06\_12**; dhe
5. Ankesën e KEK-ut me datë 20.07.2012.

**Në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2012 nxori këtë:**

### VENDIM

- I **REFUZOHET** ankesa e KEK-ut ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A. K. (shifra në KEK: DPR - 90027530), nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_813\_06\_12 i datës 29.06.2012.

### Arsyetim

Me datë 14.12.2011 me kërkesë të konsumatorit punëtorët e autorizuar të KEK-ut , për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik nr. 32265733 e furnizon shifrën DPR90027529, ndërsa njehsori elektrik nr. 32265733 e furnizon shifrën DPR90027529, ndërsa njehsori elektrik nr. 32265734 e furnizon shifrën DPR 90027530.

Departamenti për Faturim në KEK me datë 27.12.2011 përmes urdhër lejimit/ngarkimit nr. 38668 ka bërë korrigjimin e faturave për periudhën 12/2010 deri më 11/2011 bazuar në procesverbalin kontrollues nr. 1348013 të datës 14.12.2011 në vlerë prej 1,002.04 €, si dhe transferimin e njehsorit nr. 32265733 nga shifra DPR 90027530 në shifrën DPR 90027529. Pas kësaj konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar korrigjimin. Me datë 10.01.2012 Departamenti për Konsumatorë në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke u thirrur në procesverbalin e kontrollës nr. 1348013 të datës 14.12.2011. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 26.07.2012 ka nxjerr vendim duke **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të anuloj korrigjimin e bërë nga KEK-u për shifrën DPR – 90027530 sipas urdhër lejimit/ngarkimit nr. 38668 të datës 27.12.2011, si dhe ka kërkuar nga KEK-u që të bëjë



korrigjimin e faturave për shifrat DPR – 90027530 dhe shifrën DPR – 90027529 duke marrë periudhën prej 01/2003 e deri më 11/2011.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 25.07.2012 KEK-u ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, me të cilën ka kundërshtuar në tërësi vendimin e DMK-së nr. **ZRRE/DMK\_V\_813\_06\_12** të datës 29.06.2012. Konstatimet e KEK-ut, të theksuara në ankesë janë se gjatë analizave të provave dhe fakteve nuk ka pasur ngatërrim me furnizim nga njehsorët e konsumatorëve.

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 16.01.2003 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit “W. C.”, dhe gjatë këtij inspektimi kanë bërë pranimin teknik të njehsorit elektrik nr. 32265734. Punëtorët e autorizuar të KEK-ut po ashtu kanë regjistruar të dhënat teknike të pikës matëse si dhe njehsorin elektrik e kanë vulosur me vulë distributive, po ashtu në të njëjtën datë kanë bërë pranimin teknik të njehsorit elektrik nr. 32265733.

Konsumatori A. K. me shifër DPR – 90027530 pas dyshimit të tij në shpenzimin e energjisë elektrike ka parashtruar kërkesë në KEK për inspektim të pikës matëse. Me datë 14.12.2011 me kërkesë të konsumatorit A. K. me shifër DPR 90027530, punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se njehsori elektrik nr. 32265733 e furnizon shifrën DPR 90027529 ndërsa njehsori elektrik nr. 32265734 e furnizon shifrën DPR 90027530.

Gjatë analizës së rrjedhës së energjisë elektrike dhe transaksioneve të konsumatorëve të DPR – 90027530 dhe DPR – 90027529 konstaton se korrigjimi i faturave të konsumatorit është bërë gabim, pasi që është bërë vetëm për periudhën një vjeçare duke bërë zbritjen e faturave nga shifra DPR 90027530 në shifrën DPR 90027529 e që bazuar në proceset e pranimit të instalimit elektrik saktësisht dihet koha e vendosjes së njehsorëve elektrik si dhe faturimi i konsumatorëve është bërë bazuar në shpenzimet reale mujore.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të bërë lidhur me shpenzimin e energjisë elektrike shifrave të konsumatorit DPR – 90027530 dhe DPR – 90027529 ka vërejtur se, mesatarja e shpenzimeve të energjisë elektrike nga periudha 01/2003 e deri te procesi i inspektimit 14.12.2011 për shifrën DPR – 90027530 ka qenë 78.22€ apo shuma e përgjithshme ka qenë 8369.26€, ndërsa mesatarja e shpenzimeve të energjisë elektrike nga periudha 01/2003 e deri te procesi i inspektimit 14.12.2011 për shifrën DPR – 90027529 ka qenë 21.95€ apo shuma e përgjithshme ka qenë 2348.16€. Ndërsa pas inspektimit të pikës matëse të bërë nga punëtorët e autorizuar të kontrollës me datë 14.12.2011, vërehet se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike për shifrën DPR – 90027530 prej periudhës 12/2011 – 05/2012 është 10.62€ apo shuma e përgjithshme e shpenzimeve është 63.72€, ndërsa se mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike për shifrën DPR – 90027529 prej periudhës 12/2011 – 05/2012 është 79.97€ apo shuma e përgjithshme e shpenzimeve është 479.82€. Nga kjo shihet se pas inspektimit të pikës matëse të bërë nga punëtorët e autorizuar të kontrollës së KEK-ut 14.12.2011 në shifrën DPR – 90027530 ka pësuar rënie të madhe shpenzimi i energjisë elektrike, për shkak të konstatimit se njehsori elektrik nr. 32265733 i cili është menduar se furnizon shifrën DPR – 90027530 të konsumatorit Ali Kllokoqi realisht nuk është ai njehsori dhe se njehsoi i cili furnizon saktë shifrën DPR – 90027530 është njehsori elektrik 32265734 i cili njehsor deri në momentin e inspektimit ka qenë i lidhur te shifra DPR – 90027529.

Bordi i ZRRE-së pas verifikimit dhe analizimit te proceseve të KEK-ut ka konkluduar se tek ky konsumator kemi të bëjmë me një gabim të shkaktuar nga vet punëtorët e KEK-ut, sa i përket lidhjeve të njehsorëve elektrik për shifrat e cekura më lartë dhe se në këtë rast nuk është bërë korrigjim i saktë i shpenzimeve të energjisë elektrike nga ana e KEK-ut. Sipas analizave të bëra këtyre



procesverbaleve dhe korigjimit të KEK-ut konstatojmë se korigjimi i shpenzimeve duhet të bëhet në atë mënyrë që shpenzimet e faturuara në shifrën DPR 90027530 për shpenzimet e regjistruar në njehsorin elektrik nr. 32265733 për periudhën 01/2003 deri më 11/2011 të barten në shifrën DPR 90027529 ndërsa shpenzimet e faturuara për njehsorin elektrik nr. 32265734 në shifrën DPR 90027529 për periudhën 01/2003 deri më 11/2011 të barten në shifrën DPR - 90027530.

Në ankesën e KEK-ut theksohet se lidhur me shifrat e këtyre konsumatorëve nuk ka ndonjë provë bindëse se është bërë ndonjë ngatërrim në furnizim nga njehsorët e këtyre konsumatorëve, si provë theksohet procesverbali i KEK-ut nr. 1346 i datës 16.01.2003, si dhe njëherit ka propozuar që të aprovohet kundërshtimi i KEK-ut dhe borxhi i theksuar më sipër të ngelet kontest deri në përfundimin e të gjitha procedurave ligjore.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12 tetor 2012 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut. Kundërshtimet në ankesën e KEK-ut, se në këto shifra të theksuara më lart se nuk ka pasur ngatërrim të njehsorëve nuk qëndrojnë. Konstatimet e KEK-ut të theksuara në ankesë bien në kundërshtim me veprimet e marra po nga kjo ndërmarrje pasi që ekzistojnë prova se Departamenti i faturimit të KEK-ut me datë 27.12.2011 përmes urdhër lejimit/ngarkimit numër 38668 ka bërë korigjimin e faturave për periudhën 12/2010 deri më 11/2011 bazuar në procesverbalin kontrollues të punëtorëve të KEK-ut nr. 1348013 të datës 14.12.2011 në vlerë prej 1,002.04 € si dhe transferimin e njehsorit elektrik nr. 32265733 nga shifra DPR 90027530 në shifrën DPR 90027529.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEK në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, gjithashtu ankesa e KEK-ut, nuk i përmban elementet bazë të një ankese pasi që është shumë e mangët për kah përmbajtja. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së gjatë nxjerrjes së vendimit, por që KEK vetëm është thirr në formën e përgjithësuar pa konkretizuar decidivisht se ku janë bërë shkeljet gjatë nxjerrjes së këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2012 ka analizuar ankesën e KEK-ut dhe vendimin e nxjerrë nga ana e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_813\_06\_12, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar